

Jeton Shasivari, PhD<sup>1</sup>

UDC:

341.171.071.51:342.4(497.7)

**ASPEKTET KUSHTETUESE TË INTEGRIMIT TË REPUBLIKËS SË  
MAQEDONISË NË BASHKIMIN EVROPIAN-SFIDAT DHE  
PERSPEKTIVAT**

**УСТАВНИТЕ АСПЕКТИ НА ИНТЕГРАЦИЈАТА НА  
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА ВО ЕВРОПСКАТА УНИЈА-  
ПРЕДИЗВИЦИ И ПЕРСПЕКТИВИ**

**CONSTITUTIONAL ASPECTS OF THE INTEGRATION OF THE  
REPUBLIC OF MACEDONIA IN THE EUROPEAN UNION-  
CHALLENGES AND PERSPECTIVES**

**Abstract**

The European Union represents a distinct legal and political structure incorporating the features of federal and confederal regulation, and therefore, the EU is defined as an international supranational organization, which has implications for the national constitutional systems of member states of EU as well as for the states that want to integrate into the EU. The Republic of Macedonia is in the process of joining the European Union. Taking into account that the states that want to access must ensure the full and proper application of the EU acquis on their territory, and there is a need for the Constitution of the Republic of Macedonia to be amended in order to fulfill this obligation. In order to meet the requirements arising from the integration into the legal system of the European Union, almost all member states of the

---

<sup>1</sup> Autori është Profesor i Asociuar në lëmin: E drejta kushtetuese dhe administrative në Fakultetin Juridik të Universitetit të Evropës Jug-Lindore-Tetovë dhe Zëvendës-President i Bordit për akreditim dhe evaluim të arsimit të lartë në RM-Shkup. Adresa e postës elektronike: j.shasivari@seeu.edu.mk.

European Union have changed their Constitution. Therefore, the main goal of this paper is to determine the constitutional alternatives and implications regarding the fulfillment of the political criteria for the integration of the Republic of Macedonia into the European Union. Special attention will be paid to creating a constitutional basis for incorporating EU law into domestic law of the Republic of Macedonia. In this sense, the key issue of this paper is the need and priorities of the constitutional changes in the Republic of Macedonia, namely, what kind of constitutional reform is needed for Republic of Macedonia and what constitutional technique should be applied in this direction (a separate chapter in the Constitution of the Republic of Macedonia, adoption of constitutional amendments or complete constitutional review). Therefore, in this direction, there will be of particular importance the comparative analysis of the different experiences of the EU Member States, and especially of Croatia as former state of the former Yugoslav Socialist Federation, including the former Socialist Republic of Macedonia.

**Key words:** EU, Constitution of RM, Constitutional Reform, Constitutional Alternatives, Harmonization, Constitutional Technique.

### 1. Hyrje

Objekti i së drejtës kushtetuese evropiane përbëhet nga: marrëdhëniet shoqërore, normat dhe vlerat, që përbëjnë një tërësi më të fortë se objekti i së drejtës kushtetuese të brendshme, meqë vlerat janë objekt periferik i së drejtës kushtetuese të brendshme. Marrëdhëniet shoqërore, nga njëra anë, i përfshijnë marrëdhëniet midis njerëzve dhe pushtetit, kurse nga ana tjetër, marrëdhëniet midis organeve të BE-së me shtetet anëtare. Marrëdhëniet midis njerëzve dhe pushtetit shpërfaqen përmes lirive dhe të drejtave të njeriut dhe organizimit të BE-së kështu që, objekti i së drejtës kushtetuese evropiane nuk ndryshon shumë nga objekti i së drejtës kushtetuese të brendshme. Liritë dhe të drejtat e njeriut zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën kushtetuese evropiane gjë që është e kuptueshme mbase BE-ja më tepër zhvillohet si një bashkësi e njerëzve e më pak si një bashkësi e shteteve, siç shprehet Zhan Mone: “Ne nuk i bashkojmë shtetet por, i bashkojmë njerëzit”. Organizimi i pushtetit paraqet segmentin e dytë të marrëdhënieve

shoqërore, i cili përfshin: konstituimin, kompetencën, aktet dhe mënyrën e vendosjes së organeve të BE-së si dhe marrëdhëniet e tyre me shtetet anëtare të BE-së. Pra, bëhet fjalë për një sistem të ndërlikuar institucional me marrëdhënie dhe metoda komplekse të funksionimit. Normat e së drejtës kushtetuese evropiane janë të shumëllojshme krahasuar me normat e së drejtës së brendshme kushtetuese, sepse materia kushtetuese rregullohet si me normat e të drejtës primare ashtu edhe me normat e të drejtës sekondare. Këto norma janë më me numër për shkak se marrëdhëniet shoqërore janë më të ndërlikuara në BE se sa në shtetet nacionale. Vlerat paraqesin një element mjaft të rëndësishëm të objektit të së drejtës kushtetuese evropiane. Ato shprehimisht theksohen në aktet themeltare të BE-së e, posaçërisht në Traktatin kushtetues për Evropën të v. 2004 dhe në Traktatin e Lisbonës të v. 2007 meqë bëhet fjalë për vlera universale, si: liritë dhe të drejtat e njeriut, liria, paqja, drejtësia, demokracia, barazia dhe shteti i së drejtës. Metodat e së drejtës kushtetuese evropiane janë të ngjashme me metodat e së drejtës kushtetuese të brendshme, por, me dallimin që konsiston në zbatimin e tyre lidhur me krijimin dhe interpretimin e normave meqë subjektet e së drejtës kushtetuese evropiane janë më kreativë në krijimin, interpretimin dhe zbatimin e normave, krahasuar me subjektet e së drejtës kushtetuese të brendshme gjë që shihet në rolin kreativ të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë me seli në Luksemburg.

Përmbajtja e së drejtës kushtetuese evropiane është më komplekse se përmbajtja e së drejtës kushtetuese të brendshme meqë ajo është më dinamike sepse BE-ja u ekspozohet ndryshimeve më të shpeshta. Pra, e drejta kushtetuese evropiane zhvillohet shpejtë dhe ka perspektivë për dallim nga e drejta kushtetuese e brendshme e cila është në krizë sepse edhe shteti nacional është në krizë. Sipas Karl Shmit, shteti nacional është i kufizuar në aspektin kohor dhe është i gjykuar të zhbëhet. Ai thotë: “Shteti është një fenomen që është i kufizuar në aspektin kohor. Shteti ekziston vetëm 500 vite, nga v. 1500 deri në v. 2000, pra, afër një mileniumi. Më pas do të ndodh diç tjetër dhe, më tepër se kjo nuk mund të them. Shteti është duke u bërë makinë, instrument. Shërbehesh me të dhe më pas, heqësh dorë prej tij”<sup>2</sup>.

<sup>2</sup> Për më tepër shih: Шкарик, Др., Светомир; Давкова-Сиљановска, Др., Гордана; Уставно право (Второ дополнето и изменето издание), Скопје, 2009, стр. 21-24, dhe 58, cituar sipas: Жан Моне, Европа-Нашиот заеднички дом, Скопје, 2007, стр. 58. Poashtu, cituar sipas: Фулко, Ланкестер, Правник суочен са самим собом (Разговор са Карлом Шмитом), 1-4, Београд, 2005, стр. 21.

Në të drejtën ndërkombëtare, një organizatë shoqërore (entitet politik) për të qenë shtet, duhet kumulativisht të plotësojë katër kushte, edhe atë: së pari, të ketë territorin e vet; së dyti, të ketë popullatën e përhershme; së treti, qeveria legjitime që efektivisht kontrollon territorin e vet, dhe së katërti, kapaciteti për të hyrë në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, shtrohet pyetja se ç'është Bashkimi Evropian?

Sipas Traktatit të Mاستrihtit të v. 1992, BE paraqet një tërësi unifikuese që përmbledh tri shtylla, edhe atë: shtylla e parë (komunitetet evropiane), shtylla e dytë (politika e përbashkët e sigurisë dhe politika e jashtme) dhe shtylla e tretë (punët e brendshme dhe drejtësia). Pra, BE nuk është as shtet e as organizatë ndërkombëtare, por paraqet një entitet sui generis me një qeverisje që lëvizë midis ndër-qeveritares dhe supranacionales, ku bëjnë pjesë 28-të shtete anëtare (shteti anëtar i 28-të është Kroacia që u anëtarësua në v. 2013), kurse shtetet kandidatë janë: Islanda, Mali i Zi, Serbia, RM dhe Turqia, kurse kandidatë potencial janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova. Nëse analizohen katër kushtet e mësipërme për të qenë shtet, në rastin e BE-së ato kushte mungojnë, përkatësisht, mungon elementi i territorit sepse BE nuk ka një territor të vetin unik, por përbëhet prej territoreve të shteteve anëtare. Madje edhe kufijtë e brendshëm të Shengenit nuk janë unik, përkatësisht Danimarka nuk është pjesë e Shengenit. BE nuk plotëson as edhe elementin e dytë, atë të popullit, sepse nuk ka popull të vetin, por përbëhet prej popujve të shteteve anëtare. Po ashtu, BE nuk plotëson edhe kushtin e tretë, pra atë të qeverisë nën frymën e parimit të ndarjes së pushtetit, por funksionon në bazë të një modeli të qeverisjes shumë-shtresore me përzjerje të kompetencave ligjvënëse dhe ekzekutive, dhe nëse një ditë, BE do të shndërrohej në një shtet federativ atëherë do të funksiononte sipas parimit të ndarjes së pushtetit: Parlamenti evropian dydhomësh si bartës i pushtetit ligjvënës, Komisioni Evropian si qeveri evropiane përkatësisht bartëse e pushtetit ekzekutiv dhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë si një Gjykatë supreme evropiane përkatësisht bartëse e pushtetit gjyqësor. BE nuk plotëson as edhe kushtin e katërt, atë të kapacitetit për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare sepse BE nuk ka ministrinë e punëve të jashtme, nuk ka ulëse të veten në OKB dhe nuk ka politikë unike të jashtme siç ishte rasti me mospasjen e qëndrimit

unik të BE-së gjatë prishjes së ish-RSFJ-së, luftërave në Irak dhe Afganistan, njohjes së Republikës së Kosovës, etj.<sup>3</sup>

Traktati kushtetues për Evropën i v. 2004 që duhej të hynte në fuqi në v. 2006, pasi të ratifikohet nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së, nuk parashihte alternativa se çfarë do të ndodhte nëse i njëjti nuk pranohej nga shtetet anëtare, edhe pse ky Traktat u ratifikua nga 16-të shtete anëtare, mirëpo, dështoi në v. 2005 në referendumet në Francë dhe në Holandë. Kështu që, çështja rreth këtij dokumenti filloi të lëvizë në v. 2007 kur kryesimin me BE-në e mori Gjermania, me ç'rast në po atë vit nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së u miratua Deklarata e Berlinit e cila theksonte synimin e të gjitha shteteve anëtare që të miratohej një Traktat i ri deri në mesin e v. 2009. I gjithë ky proces i zëvendësimit të Traktatit kushtetues për Evropën me Traktatin e ri reformues u finalizua më 19 tetor 2007 me arritjen e konsensusit të të gjitha shteteve anëtare të BE-së mbi Traktatin e ri të njohur si: “Traktati i Lisbonës” i cili në kuptimin material është identik më të parin, por i ndryshëm në kuptimin formal, sepse mënjanoi pjesën më të madhe të terminologjisë kushtetuese si dhe simbolet e tekstit paraprak kushtetues, përkatësisht mënjanoi simbolet dhe terminet që asoconin në shtet, si për shembull: emërtimin-kushtetutë, simbolet e BE-së (flamuri, himni dhe motoja evropiane) si dhe mënjanimi i termit-ligje evropiane. Kështu, ndryshimet e tilla, mundësuan që Traktati i Lisbonës të miratohet në procedurat përkatëse parlamentare të shteteve anëtare, me përjashtim të Irlandës e cila sipas kushtetutës së saj duhej të organizonte referendum, me ç'rast në v. 2008 Traktati i Lisbonës u refuzua nga shumica e Irlandezëve, mirëpo, në referendumin e përsëritur në v. 2009 Traktati në fjalë mori dritën jeshile edhe nga Irlanda, kështu që në dhjetor të v. 2009 Traktati i Lisbonës u bë kornizë e re juridike për BE-në.

Po ashtu, Traktati i Lisbonës parashihte edhe ndryshime dhe risi të tjera, edhe atë:

- Inkorporimi i Kryetarit të përhershëm të Këshillit Evropian që do të vendoset nga qeveritë e shteteve anëtare me mandat prej dy vjet e gjysmë;

- Inkorporimi i Përfaqësuesit të lartë të BE-së për punë të jashtme dhe politikë të sigurisë që do të vendoset nga Këshilli Evropian me pëlqim paraprak të Kryetarit të Komisionit Evropian, si zëvendësim të ish-Përfaqësuesit të lartë të BE-së për punë të jashtme dhe siguri;

<sup>3</sup> Për më tepër shih: Reka, Dr., Blerim, Kushtetuta e UE-së - Rubikoni i supranacionales, Shkup, 2007, f. 44-47.

▪ Numri i ri i mandateve në Parlamentin Evropian përkatësisht 751 sish, me ç'rast asnjë shtet anëtar nuk do të mund të ketë mbi 96-të mandate dhe më pak se 6-të mandate;

▪ Inkorporimi i përgjegjësisë së përbashkët në mes të, nga njëra anë, Këshillit Evropian që të propozojë kandidatin për Kryetar të Komisionit Evropian, dhe nga ana tjetër, Parlamentit Evropian që të zgjedhë kandidatin për Kryetar të Komisionit Evropian;

▪ Mënyra e re e votimit në Këshillin e BE-së, përkatësisht inkorporimi i shumicës së dyfishtë sipas së cilës shumica e kualifikuar do të përcaktohej si vijon: vendimi i Këshillit do të miratohet nëse për të votojnë së paku 55% i anëtarëve që vijnë nga së paku 15-të shtete anëtare, e që përbëjnë së paku 65%-in e popullatës së BE-së;

▪ Heqja e shtyllave të BE-së, përkatësisht bashkimi i shtyllës së tretë (punët e brendshme dhe drejtësia) me shtyllën e parë (komunitetet evropiane), që domethënë se, në këtë lëmë do të vendoset me shumicë votash e jo unanimisht, dhe vendimet e tilla do të vlejnjë drejtpërsëdrejti ndaj shteteve anëtare, kurse shtylla e dytë (politika e përbashkët e sigurisë dhe politika e jashtme) vazhdon të mbetet si shtyllë e veçantë<sup>4</sup>.

## **2. Marrëdhëniet ndërkombëtare në Kushtetutën e RM-së me fokus integrimi në BE - Modeli kushtetues kroat**

Nëse analizojmë sistemin normativ të Kushtetutës së RM-së përkitazi me marrëdhëniet ndërkombëtare, si bazë nismëse kushtetuese për integrimin e RM-së në BE mund të shërbejnë dispozitat kushtetuese të katër neneve (nenet 118-121), ku thuhet se, marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar në pajtim me Kushtetutën janë pjesë e rendit juridik të brendshëm dhe nuk mund të ndryshohen me ligj. Marrëveshjet ndërkombëtare në emër të Republikës së Maqedonisë i lidh Kryetari i Republikës së Maqedonisë. Marrëveshje ndërkombëtare mund të lidh edhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë kur kjo është përcaktuar me ligj. Propozim për asocim në bashkime ose në bashkësi me shtetet e tjera ose për dalje nga bashkimi ose nga bashkësia me shtetet e tjera mund të paraqesë Kryetari i Republikës, Qeveria ose së paku 40 deputetë. Vendimin për asocim ose për dalje nga bashkimi ose nga bashkësia me shtetet e tjera e merr Kuvendi me shumicë prej dy të

<sup>4</sup> Për më tepër shih: Shasivari, Dr., Jeton; E drejta kushtetuese, Libri I, Furkan ISM, Shkup, 2015, fq. 25-26, cituar sipas: Čapeta, Dr., Tamara, “Evropska Unija po Lisabonskom Ugovoru”, Hrvatska Javna Uprava, god. 10, br. 1, Zagreb, 2010, str. 35-47.

tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Vendimi për asocim ose për dalje nga bashkimi ose nga bashkësia me shtetet tjera është miratuar, nëse në referendum për të ka votuar shumica nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve. Vendim për asocim në anëtarësi ose për dalje nga anëtarësia në organizatat ndërkombëtare merr Kuvendi me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve në bazë të propozimit të Kryetarit të Republikës, Qeverisë ose së paku 40 deputetëve<sup>5</sup>.

Sipas modaliteteve të ndryshme të ndryshimeve kushtetuese në të drejtën kushtetuese të krahasuar lidhur me nevojën e integritit të shteteve në BE (siç janë: Rumania, Sllovenia, Sllovakia, Çekia, Polonia, Hungaria, Kroacia, Letonia, etj.), e që mund të shërbejnë si një model referues për Republikën e Maqedonisë, duhet veçuar standardin kushtetues kroat ku është intervenuar në Kushtetutën e Kroacisë me inkorporimin e një kapitulli të veçantë, pra Kapitulli i VIII-të me gjithsej 4 pika, e që i referohet rregullimit të marrëdhënieve të Kroacisë me Bashkimin Evropian. Kështu, në kapitullin e VIII-të të Kushtetutës së Kroacisë, në pikën 1, e cila rregullon: Bazën juridike të anëtarësimit dhe bartjen e autorizimeve kushtetuese, theksohet se, Republika e Kroacisë, në bazë të nenit 142 të Kushtetutës, si shtet anëtar i Bashkimit Evropian, merr pjesë në krijimin e unitetit evropian për të siguruar paqe, liri, siguri dhe prosperitet të qëndrueshëm së bashku me shtetet e tjera evropiane dhe për të arritur qëllime të tjera të përbashkëta në përputhje me parimet themelore dhe vlerat mbi të cilat është themeluar Bashkimi Evropian. Republika e Kroacisë, në bazë të neneve 140 dhe 141 të Kushtetutës, i beson institucionet e Bashkimit Evropian kompetencat e nevojshme për ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve të marra në bazë të anëtarësimit. Në pikën 2, e cila rregullon: Pjesëmarrjen në institucionet e BE-së, theksohet se, qytetarët e Republikës së Kroacisë janë drejtpërdrejtë të përfaqësuar në Parlamentin Evropian, ku përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur vendosin për çështjet brenda kompetencave të tyre. Parlamenti Kroat merr pjesë në procesin legjislativ evropian në përputhje me traktatet mbi të cilat themelohet Bashkimi Evropian. Qeveria e Republikës së Kroacisë i raporton Parlamentit kroat mbi propozimet për rregullat ligjore dhe vendimet në të cilat merr pjesë në institucionet e Bashkimit Evropian. Parlamenti kroat mund të bëjë këto konkluzione në bazë të të cilave qeveria vepron në

<sup>5</sup> Shasivari, Dr., Jeton; E drejta kushtetuese, Libri I, Furkan ISM, Shkup, 2015, f. 450-451.

institucionet e Bashkimit Evropian. Mbikëqyrja e parlamentit kroat mbi veprimtaritë e Qeverisë së Republikës së Kroacisë në institucionet e Bashkimit Evropian rregullohet me ligj. Republika e Kroacisë në Këshillin Evropian, në përputhje me kompetencat e tyre kushtetuese, përfaqësohet nga Qeveria dhe Presidenti i Republikës së Kroacisë. Në pikën 3, e cila rregullon: Të drejtën e BE-së, theksohet se, realizimi i të drejtave që rrjedhin nga *acquis communautaire* është i barabartë me realizimin e të drejtave të garantuara me rendin juridik kroat. Aktet ligjore dhe vendimet e pranuar nga Republika e Kroacisë në institucionet e Bashkimit Evropian zbatohen në Republikën e Kroacisë në përputhje me *acquis communautaire*. Gjykatat kroate mbrojnë të drejtat subjektive bazuar në *acquis communautaire*. Organet shtetërore, organet e njësisive të vetëqeverisjes lokale dhe rajonale dhe personat juridikë me autorizime publike zbatojnë drejtpërsëdrejti të drejtën e Bashkimit Evropian. Dhe, pika 4, e cila rregullon: Të drejtat e qytetarëve të BE-së, theksohet se, qytetarët e Republikës së Kroacisë janë qytetarë të Bashkimit Evropian dhe i gëzojnë të drejtat që u garantohen atyre nga *acquis communautaire*, dhe në veçanti: liria e lëvizjes dhe qëndrimit në territorin e të gjitha shteteve anëtare; të drejtën aktive dhe pasive të votimit në zgjedhjet për Parlamentin Evropian dhe zgjedhjet lokale në një shtet tjetër anëtar, në përputhje me dispozitat e atij shteti anëtar; e drejta për mbrojtje diplomatike dhe konsullore të çdo shteti anëtar, të barabartë me mbrojtjen e shtetasve të tyre kur ata janë në një vend të tretë në të cilin Republika e Kroacisë nuk ka një post diplomatik dhe konsullor; e drejta për të paraqitur një kërkesë në Parlamentin Evropian, peticione të Ombudsmanit Evropian dhe e drejta për të adresuar institucionet dhe organet këshillimore të Bashkimit Evropian në gjuhën kroate, si dhe në të gjitha gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian, dhe të drejtën për të marrë një përgjigje në të njëjtën gjuhë. Të gjitha të drejtat ushtrohen në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Traktatet në të cilat është themeluar Bashkimi Evropian dhe masat e miratuara në bazë të marrëveshjeve të tilla. Në Republikën e Kroacisë të gjitha të drejtat e garantuara nga *acquis communautaire* gëzohen nga të gjithë qytetarët e Bashkimit Evropian<sup>6</sup>.

---

<sup>6</sup> Ustav Republike Hrvatske, "Narodne novine" broj 85, 09.07.2010 - Pročišćeni tekst, Članci 143-146.

### 3. Lëmenjtë kyç kushtetues që duhen ndryshuar gjatë integritit të RM-së në BE

Përvojat e deritanishme, si të shteteve anëtare të BE-së ashtu edhe të shteteve kandidatë, japin mundësi që, të projektohen katër lëmenjtë kyç kushtetues që RM duhet t'i ndryshojë në mënyrë që të integrohet në BE, edhe atë:

- Bartja e sovranitetit në BE paraqet një rën nga çështjet kryesore, sepse BE bazohet në bartjen e të drejtave të caktuara sovrane ligjvënëse, ekzekutive-administrative dhe gjyqësore të shteteve-anëtare. Në këtë drejtim, Kushtetuta e RM-së, shquhet për nga qasja klasike rigjide ndaj sovranitetit, meqë në dispozitat e neneve 1 dhe 2, theksohet se, Republika e Maqedonisë është shtet sovran, i pavarur, demokratik dhe social. Sovraniteti i Republikës së Maqedonisë është i pandashëm, i patjetërsueshëm dhe i pakalueshëm. Në Republikën e Maqedonisë sovraniteti buron nga qytetarët dhe u takon qytetarëve. Pra, siç shihet nga këto dispozita të mësipërme kushtetuese, ekziston nevoja që, në Kushtetutën e RM-së të inkorporohet një normë autorizuese (lejuese) kushtetuese për organet shtetërore që të kenë autorizimet e duhura kushtetuese për të lidhur dhe ratifikuar Traktatet e BE-së duke bartur disa të drejta të caktuara sovrane në institucionet e BE-së, ose me fjalë të tjera, në Kushtetutën e RM-së duhet të inkorporohet norma e qartë kushtetuese e cila do të përcaktonte autorizimin që, me marrëveshje ndërkombëtare të realizohet bartja e autorizimeve kushtetuese të RM-së në Bashkimin Evropian.

- Përparësia (supremacioni) dhe efekti i drejtpërdrejtë i të drejtës së BE-së, po ashtu paraqet një çështje mjaft komplekse, sepse do nevojitet një periudhë e gjatë kohore brenda së cilës, do duhej të miratohen vendimet kryesore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në RM, për të siguruar një bazë të qartë kushtetuese të statusit primar dhe të detyrueshëm të së drejtës së BE-së ndaj të drejtës së brendshme të RM-së. Pra, kur flitet për këtë lëmi kushtetuese, raporti midis traktateve të Bashkimit Evropian dhe të drejtës së brendshme të RM-së, do të varet nga nënshkrimi dhe ratifikimi i këtyre traktateve të BE-së nga Kuvendi i RM-së, me ç'rast, e drejta e BE-së do të bëhet pjesë përbërëse e rendit juridik të brendshëm të RM-së. Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm ka edhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, edhe atë, në tre aspekte: i pari, ligjvënësit e shteteve duhet të abrogojnë dispozitat që janë në kundërshtim me të drejtën e BE-së; i dyti, në rast se paraqitet

konflikti midis dispozitës të së drejtës së brendshme dhe dispozitës të së drejtës së BE-së, atëherë përparësi ka e drejta e BE-së, dhe, i treti, gjykatësit e gjykatave nacionale në të gjitha rastet duhet të zbatojnë të drejtën e BE-së<sup>7</sup>. Siç shihet, vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë paraqesin një burim mjaft të rëndësishëm të së drejtës së BE-së sepse me ato interpretohen aktet themeltare (konstitutive) të BE-së ose plotësohen zbrazëtitrat e tyre. Përmes këtyre vendimeve, kjo Gjykatë e ka rolin e ligjvënësit ngjashëm me rolin e gjykatave kushtetuese në të drejtën e brendshme kushtetuese.

Në këtë drejtim, duhet theksuar se, ratifikimi i traktateve të BE-së në RM, gjithsesi se, do të sigurojë supremacionin e tyre ndaj të drejtës së brendshme, mirëpo, jo edhe të së drejtës sekondare të BE-së në kuadër të sistemit juridik të brendshëm, në kuptimin e parimeve të zhvilluara nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, sepse, Kushtetuta e RM-së siguron vetëm statusin superior të marrëveshjeve ndërkombëtare ndaj ligjeve të brendshme. Prandaj, në Kushtetutën e RM-së duhet inkorporuar normën kushtetuese e cila qartë do të garantonte zbatimin e saj dhe do të shërbente për tejkalimin e problemeve me të cilët do të ballafaqoheshin gjykatat e RM-së, sepse normat ekzistuese kushtetuese që i përcaktojnë burimet e detyrueshme juridike për gjykatat (pra, kushtetuta, ligjet dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare) shumë lehtë mund të shkaktojnë vështirësi të ndryshme<sup>8</sup>.

▪ Të drejtat e qytetarëve të BE-së, që para së gjithash përfshijnë të drejtën zgjedhore, pra të drejtën të votojnë dhe të votohen si kandidatë në zgjedhjet lokale dhe në Parlamentin Evropian si dhe ekstradimi i shtetasve të vendit. Në këtë drejtim, një nga risitë e Traktatit të Mastrihtit (si dhe të Traktatit të Lisbonës, neni 17) ishte edhe inkorporimi i institutit të shtetasve të BE-së, ku çdo person që ka shtetësi të ndonjërit nga shtetet-anëtare të BE-së është shtetas i BE-së, me ç'rast,

<sup>7</sup> Vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë: Komisioni kundër Republikës së Francës, nr. 167/73 (04.04.1974); Vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë: Komisioni kundër Republikës së Italisë, nr. 48/71 (13.07.1972); dhe Vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, nr. 213/89 (19.06.1990).

<sup>8</sup> Për më tepër shih: **Каракамишева-Јовановска, Др., Тања; Спировски, Др., Игор; Нечев, Зоран; Николов, Александар;** “Интеграција на Република Македонија во Европската унија–утврдување уставни импликаци и опции поврзани со политичките критериуми”, **Европскиот фонд за Балканот–заедничка иницијатива на Фондацијата „Роберт Бош“, „Кампања ди Сан Паоло“, Фондацијата ЕРСТЕ и Фондацијата „Крал Бодуен“–преку „Think and Link: Regional Policy Programme“**, Скопје, 2014, стр. 28-31.

çdo shtetas i BE-së që është rezident në shtetin anëtar shtetas i të cilit nuk është, e gëzon të drejtën që të votojë dhe të votohet në nivelin lokal, me atë që këto dispozita vlejné edhe për zgjedhjet në Parlamentin Evropian<sup>9</sup>. Po ashtu, sipas Vendimit kornizë të BE-së të 13.06.2002, shtetet anëtare të BE-së detyrohen që të ekstradojnë shtetasit e shtetit tjetër anëtar nëse ai shtet ka lëshuar fletarrestin evropian, gjë që nuk e parasheh edhe mundësinë që shtetet të mbrojnë shtetasit e vetë nga ekstradimi<sup>10</sup>. Në këtë drejtim, meqë Kushtetuta e RM-së e garanton të drejtën zgjedhore vetëm për shtetasit e RM-së, RM-ja do duhej të realizojë ndryshimin kushtetues që tu mundësojë të njëjtën edhe shtetasve të huaj që janë shtetas të shtetit anëtar të BE-së, e që dëshirojnë të kandidohen ose të votojnë në zgjedhjet lokale, pra, RM nga dita e anëtarësimit në BE tu sigurojë të drejtat e njëjta zgjedhore edhe shtetasve të BE-së me banim në RM. Po ashtu, për sa i përket, ekstradimit duhet theksuar se, RM nga v. 2011 përmes ndryshimit kushtetues në dispozitën kushtetuese të nenit 4 e inkorporoi bazën fillestare juridike kushtetuese të ekstradimit të shtetasve të RM-së shtetit tjetër në bazë të marrëveshjes së ratifikuar ndërkombëtare, me vendim të gjykatës, gjë që e thjeshtësoi mënyrën e ekstradimit, me atë që, në të ardhmen e afërt, kjo dispozitë kushtetuese, do duhej të plotësohet edhe me mundësinë e ekstradimit në pajtim me të drejtën e BE-së.

▪ Rirregullimi i raporteve midis pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv, si pasojë e bartjes së pushtetit ligjvënës në institucionet e BE-së, po ashtu paraqet një çështje mjaft të rëndësishme për sa i përket rolit të Kuvendit të RM-së në miratimin e vendimeve për çështjet që për nga burimi janë në kompetencën e tij si dhe, aktiviteti i ngjeshur në implementimin e direktivave të BE-së, që do ketë për pasojë edhe delegimin e një pjesë të pushtetit ligjvënës në pushtetin ekzekutiv. Në këtë drejtim, do të ketë nevojë për ndryshime kushtetuese në tre drejtime, edhe atë: e para, ndryshime që do të fuqizonin rolin e Kuvendit në kontrollimin efikas të Qeverisë dhe administratës në përgjithësi; e dyta, ndryshime që qartë do të rregullonin çështjen se kush do ta përfaqësojë shtetin e RM-së në Këshillin Evropian, kryetari i Republikës apo kryetari i

<sup>9</sup> <http://eur-lex.europa.eu/en/treaties/dat/11992M/htm/11992M.html>.

[http://eur-](http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:2007:306:FULL:EN:PDF)

[lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:2007:306:FULL:EN:PDF](http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:2007:306:FULL:EN:PDF).

<sup>10</sup> Framework Decision 2002/584/JHA of 13 June 2002 on the European Arrest Warrant and the Surrender Procedures between Member States, OJ No. L 190/1 of 18-07-2002.

Qeverisë, dhe e treta, meqë sipas rendit ekzistues kushtetues, Qeveria nuk ka autorizime kushtetuese që të miratojë dekrete ligjore me fuqi ligjore (përveçse në gjendje lufte dhe të jashtëzakonshme), ndërsa pas anëtarësimit në BE, aktiviteti ligjvënës në RM do të zmadhohej dukshëm, do të duhej që të rishikohet mundësia që Qeveria të ketë autorizime kushtetuese të miratojë dispozita përkatëse gjatë implementimit të direktivave të BE-së.

### CONCLUSION

Almost all EU member states had to change their constitutions in order to successfully complete the process of EU membership. Extensive effects of this process imply immediate preparation of the proposal and discussion based on the arguments of all relevant stakeholders in the public sphere in RM, especially after the current constitutional moment of opening the process of constitutional change of the name of the state in order to overcome the differences with Greece.

During the negotiations for EU membership, there is no chapter on constitutional changes as the EU is not competent to change the country's internal political and economic regulation. However, this assumption is wrong because EU membership has in many ways affected the change of the constitutional legal order of EU member states.

Like the constitutions of the candidate countries, the Constitution of the Republic of Macedonia should also be amended during the accession to the European Union. The Republic of Macedonia as a candidate for EU membership must follow the examples and models of the constitutions of the EU member states and based on their experiences to build the appropriate cohesive concept of constitutional changes with a view to its membership in the EU, given the form and content of constitutional changes.

Bearing in mind the fact that there is no ideal model in the EU and a universally accepted standard of constitutional changes, given the different experiences of EU member states with the changes of their national constitutions, as a constitutional standard in this paper is preferable the Croatian constitutional technique, i.e. the incorporation of a special constitutional chapter devoted to the European Union and which will regulate the four most important issues of the membership of the Republic of Macedonia in the European Union, namely: The Legal basis of membership and the transfer of constitutional authorizations; Participation in EU Institutions; EU Law and The Rights of EU Citizens.

**Recensentë:****Prof. Dr. Bajram Pollozhani****Prof. Dr. Omer Ismaili****REFERENCAT:**

1. Čapeta, Dr., Tamara, “Evropska Unija po Lisabonskom Ugovoru”, Hrvatska Javna Uprava, god. 10, br. 1, Zagreb, 2010.

2. Čapeta, Dr., Tamara, “Nacionalni Ustav i nadređenost prava EU u eri pravnog pluralizma”, Zbornik PFZ, 59, (1) 63-96 Zagreb, 2009.

3. Framework Decision 2002/584/JHA of 13 June 2002 on the European arrest warrant and the surrender procedures between Member States, OJ No. L 190/1 of 18-07-2002.

4. <http://eur-lex.europa.eu/en/treaties/dat/11992M/html/11992M.html>.

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:2007:306:FULL:EN:PDF>.

**5. Каракамишева-Јовановска, Др., Тања; Спировски, Др., Игор; Нечев, Зоран; Николов, Александар; “Интеграција на Република Македонија во Европската унија–утврдување уставни импликации и опции поврзани со политичките критериуми”, Европскиот фонд за Балканот–заедничка иницијатива на Фондацијата „Роберт Бош“, „Кампања ди Сан Паоло“, Фондацијата ЕРСТЕ и Фондацијата „Крал Бодуен“–преку „Think and Link: Regional Policy Programme“, Скопје, 2014.**

6. Marinković, Dr., Tanasije, “Evropeizacija Ustavnog prava”, Pravo i društvo–časopis za pravnu i političku kulturu, Beograd, 2010.

7. Podolnjak, Dr., Robert, “Hrvatsko članstvo u EU i ustavne opcije europske budućnosti”, Zbornik PFZ, 56 (5) 1495-1530 Zagreb, 2006.

8. Reka, Dr., Blerim, Kushtetuta e UE-së-Rubikoni i supranacionales, Shkup, 2007.

9. Rodin, Dr., Siniša, “Evropska Unija i Njemački Ustavni sud”, Politička Misao, vol. XXXIII, br. 4, 1996, Zagreb.

10. Shasivari, Dr., Jeton; E drejta kushtetuese, Libri I, Furkan ISM, Shkup, 2015.

11. Шкарик, Др., Светомир dhe Давкова-Сиљановска, Др., Гордана, Уставно право (Второ дополнето и изменето издание), Скопје, 2009.

12. Ustav Republike Hrvatske, “Narodne novine” broj 85, 09.07.2010–Pročišćeni tekst, Članci 143-146.

13. Vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë: Komisioni kundër Republikës së Francës, nr. 167/73, (04.04.1974).

14. Vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë: Komisioni kundër Republikës së Italisë, nr. 48/71, (13.07.1972).

15. Vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, nr. 213/89, (19.06.1990).